



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr 01/1 Prot

Tiranë, më 15.01.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 15.01.2020 ditë e mërkurë, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Besnik Cani
6. Arben Dollapaj
7. Bujar Sheshi
8. Kosta Beluri
9. Vate Staka
10. Sander Beci

Nuk është i pranishëm anëtari:

Esmeralda Keshi (për arsye shëndetësore)

Gjithashtu, janë të ftuar të jenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT dhe EURALIUS, Ministria e Drejtësisë si dhe vëzhgues nga organizata të tjera.



Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Sekretari i Përgjithshëm znj. Ilirjana Nano
2. Drejtori i Kabinetit znj. Edlira Cimbi

Mbledhja e u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstaton vlefshmërinë e mbledhjes, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i numrit maksimal të kandidatëve për magjistratë në profilin prokuror, në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021.
2. Miratimi i projekt aktit “Për caktimin e përkohshëm të z. Gjon Fusha në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Gjirokastrë”.
3. Prezantimi i opinioneve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për tu komanduar në tre pozicione në Prokurorinë e Përgjithshme, përgatitur nga Komisionin i Zhvillimit të Karrierës.
4. Miratimi i projekt aktit për dhënie leje të papaguar bazuar në kërkesën e prokurorit.
5. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit lidhur me përcaktimin e numrit maksimal të kandidatëve për magjistratë në profilin prokuror, në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021.*

Kryetari bën me dije Këshillin për takimet që ai ka zhvilluar me përfaqësues të Shkollës së Magjistraturës dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pas disa takimesh, Shkolla e Magjistraturës, propozoi një numër total prej 75 magjistratësh dhe 25 kandidatë për ndihmës në sistemin gjyqësor. U arrit në përfundimin se një ndarje prej 40 kandidatësh për gjyqtarë dhe 35 kandidatë për prokuror, do të ishte një ndarje e arsyeshme, bazuar kjo në nevojën që ka sistemi gjyqësor për kuadër. Në këto kushte propozimi është që, Këshilli të miratojë kuotën prej 35 kandidatësh. Relaton projekt vendimin, mbështetur në nenin 29 të ligjit “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe në nenin 183 të ligjit nr.96/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi që numri maksimal i kandidatëve për prokurorë, që do të pranohen në vitin akademik 2020-2021 në Shkollën

e Magjistraturës, është 35. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Znj. Seiti ngriti shqetësimin për faktin nëse rritja e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, mund të disharmonizonte cilësinë e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës. Shtroi pyetjen, nëse në takimet mes Kryetarit dhe drejtuesve të kësaj shkolle, është diskutuar themeli mbi të cilin do të vinte kjo rritje e numrit dhe zhvillimet të cilat çuan në marrjen e këtij vendimi. Propozoi bërjen e një analize nga ana e Shkollës së Magjistraturës mbi kapacitetet e saj për pranimin e studentëve.

Z. Balla i cili në mënyrë të përmbledhur propozoi: Këshilli duhet t'ia bëjë me dije Shkollës së Magjistraturës që të marrë masat për t'iu përgjigjur ritmit të reformës dhe të rrisin kapacitetet.

Z. Bazaj i cili në mënyrë të përmbledhur propozoi: që çdo anëtar i Këshillit duhet ti vihet në dispozicion dokumentat shoqëruese dhe jo vetëm relacione apo projekt vendimet.

Në përfundim të diskutimeve **Z.Ibrahimi** hedh në votim miratimin e projektaktit:

Votuan “**pro**” projekt vendimit/propozimit, anëtarët e KLP si më poshtë:

1. Gent Ibrahimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Besnik Cani
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Vate Staka
9. Sandër Beci

votuan “**kundër**” anëtarët e KLP si më poshtë:

1. Tartar Bazaj.

Miratohet me 9 vota pro dhe 1 votë kundër projektaktit të propozuar në Këshill.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projekt aktit “Për caktimin e përkohshëm të z. Gjon Fusha në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Gjirokastër”.*

I kaloj fjalën z. Vate Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili prezantoi përpara Këshillit relacionin e miratuar nga Komisioni i Karrierës lidhur me çështjen:



Z.Staka u shpreh se në nenin 62 mbi “Caktimet e përkohshme”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Komisionit i Pavarur i Kualifikimit në datën 08.07.2019 ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ish-drejtesit të Prokurorisë së Apelit, Gjirokastër, i cili e ka apeluar vendimin. Në këto kushte, deri në marrjen e formës së prerë të këtij vendimi, prokurori konsiderohet i pezulluar, është në pamundësi për të ushtuar funksionin dhe pozicioni konsiderohet përkohësisht i lirë. Në kushtet e emergjencës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendim nr. 123 datë 12.07.2019 ka caktuar përkohësisht në pozicionin e Drejtuesit, z. Gjon Fusha për periudhën 15.07.2019-15.10.2019. Po kështu KLP, ka përsëritur caktimin e përkohshëm për këtë Drejtues. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, propozon që prokurori Gjon Fusha të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 16.01.2020-15.04.2020.

Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit.

Kryetari i ftoi anëtarët për diskutim rreth materialit të paraqitur dhe nga anëtarët u drejtuan këto pyetje:

1. Znj.Seiti pyet nëse kur të miratohet Rregullorja për ngritjen në detyrë dhe të hapet gara për titullarë, caktimi i përkohshëm do të përbënte pengesë apo jo.
2. Z. Ibrahimimi dhe z. Cani dhanë këto përgjigje:

Nuk përbën asnjë pengesë.

Në përfundim të diskutimeve **Z.Ibrahimimi** hedh në votim projektvendimin:

Votuan “**pro**” projekt vendimin, anëtarët e KLP si më poshtë:

- 1.Gent Ibrahimimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Besnik Cani
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Vate Staka



9. Sandër Beci
10. Tartar Bazaj

Miratohet me 10 vota pro çdo akt i projektvendimit.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Prezantimin e opinionëve për kandidatët, të cilët kanë shprehur interesin për tu komanduar në tre pozicione në Prokurorinë e Përgjithshme, përgatitur nga Komisionin i Zhvillimit të Karrierës.*

I kaloj fjalën z.Beci si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53,54,55,56,58, të ligjit 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, më datën 19.12.2019, shpalli procedurën për shprehjen e interesit për tu komanduar në tre pozicione. Brenda afatit dy javor, u paraqitën këto kërkesa: Pranvera Pushtina, Olsi Dado, Arens Çela dhe Olgert Romnici dhe Edmonda Hoxha. Komisioni në bazë të nenit 54/4 të ligjit “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” i propozon Këshillit që të miratojë projekt-opinion lidhur me këtë çështje.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Balla është dakord me shprehjen e opinionit.

Z. Bazaj ngre shqetësimin që Këshilli duhet të njihet me të gjithë dokumentacionin e kandidatit. Nuk është dakord me përjashtimin nga gara, edhe pse Komisioni ka arsyetuar skualifikimin. Të njëjtin shqetësim shprehu dhe znj. Seiti, edhe pse Komisioni ka përgatitur një material të hollësishëm ku arsyetohet shkaku i përjashtimit, propozon që askush nga kandidatët të mos përjashtohet dhe ti lihet Prokurorit të Përgjithshëm të vendosë cili do të jetë pjesë e stafit të tij.

Z. Cani i kërkoi Këshillit që të marrë një vendim. Citoi nenin 54, i ligjit “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” pika 4,5,6, (procedura e komandimit).

Relatori i çështjes z. Beci dha këto përgjigje:

1. Për përjashtimin nga gara të z. Olgert Romnici, e arsyetuar nga letra e Drejtueses së Prokurorisë për shkak të ngarkesës që ka Prokuroria e Beratit, është prokuroria e tretë me ngarkesën më të madhe në Republikë.
2. Për përjashtimin e znj. Edmonda Hoxha, kërkesë e cila nuk u pranua pasi kjo prokurore nuk gëzonte statusin e magjistratit, kusht i domosdoshëm.

Rreth pyetjeve u bënë plotësime nga anëtarët e komisionit si vijon:



1. Z.Balla u shpreh se Këshilli duhet të tregohet i kujdesshëm me opinionet e Drejtuesve të Prokurorive.
2. Z. Beluri u shpreh se, është e pamundur që anëtarëve të Këshillit tu vihen në dispozicion të gjitha aktet.(në përgjigje të kërkesës së z. Bazaj)
3. Z. Bazaj kundërshton z. Beluri duke sqaruar që, kjo është një detyrim ligjor (neni 164, pika 6, të ligjit nr.115/2016).
Z. Ibrahim i bën me dije se, administrimi nga anëtarët e Këshillit i çdo akti nga puna që bëjnë Komisionet, do të ishte një ngarkesë e tepruar dhe do të cënonte avantazhet organizative të punës së Këshillit, i cili është i organizuar në Komisione të Përhershme sipas funksioneve të përcaktuara.
4. Z. Sheshi z. Balla, Znj. Seiti shprehen se është e drejtë e çdo anëtar i që ti kërkojë çdo komisioni aktet që u nevojiten. Z. Sheshi dhe z. Balla konfirmojnë se është e pamundur që komisioni të shumëfishojë të gjitha aktet që disponon.

Në përfundim të diskutimeve **Z.Ibrahimi** hedh në votim opinionin lidhur me komandimet.

Miratohet me 9 vota pro dhe 1 kundër (pjesërisht), z. Bazaj.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e katërt të të rendit të ditës.

➤ *Miratimin e lejes së papaguar bazuar në kërkesën e prokurore, Esmeralda Ndoci.*

I kaloj fjalën z.Balla si relator i Komisionit të Vlerësimit dhe Aftësive Profesionale. Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka ardhur kërkesa e znj. Ndoci, prokurore pranë Prokurorisë së rrethit Shkodër, për dhënie të leje të papaguar për arsye familjare (për arsye pune bashkëshorti transferohet në një vend të huaj), për një periudhë prej 18 deri 24 muaj, (neni 24 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e magjistratit” Znj. Ndoci ka marrë miratimin e drejtueses së kësaj Prokurorie.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Bazaj shprehet se është luks dhënia e lejes në rastin konkret. Sipas tij, kjo do të ishte e justifikueshme vetëm në rastet që kanë si qëllim kualifikimin apo arsyet shëndetësore.

Z.Cani është dakord për miratimin e lejes për një periudhë 24 mujore.

Në përfundim të diskutimeve Z.Ibrahimi hedh në votim miratimin e lejes së papaguar për periudhën nga 01.02.2020-31.07.2021:

Miratohet me 8 vota pro dhe 2 kundër: Z Ibrahim i dhe z. Bazaj, me arsyetimin se për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në sistem, do të ishte e pranueshme periudha 12 mujore.



Në përfundim, Këshilli në mbledhjen e sotme plenare miratoi Vendimet për pesë pika të rendit të ditës.

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)



KRYETARI

Gent Ibrahimi

Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë proces verbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. — datë — (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve)
Proces verbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 27/01/2020
Proces verbali të arkivohet

PËRGJEGJËSI SEKTORIT SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi